

VENDIM
Nr.5, datë 10.1.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.722, DATË 25.10.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE MASËN E PËRFITIMIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË
NGA BASHKËSHORTI/JA E PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 38, pikat 1 e 2, e 55, pika 2, të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, dhe të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.722, datë 25.10.2006 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Masa e trajtimit financiar të jetë, si më poshtë vijon:

- a) 100 për qind e pagës minimale mujore, në shkallë vendi, e miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune nga 1 deri në 10 vjet.
- b) 120 për qind e pagës minimale mujore, në shkallë vendi, e miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune mbi 10 vjet.

Trajtimi i veçantë financiar ndryshon, sa herë ndryshon paga minimale mujore në shkallë vendi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16.5.2005.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha